

**[Gykata Supreme - duke vendosur mbi Konfliktin Administrativ - ankesa e refuzuar - e drejta për ndihmë sociale - neni 40 (1) LKA - neni 1.5; 3 Ligji Nr. 2003/23 mbi Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë]**

*Paditësi paraqiti ankesë kundër vendimit të Departamentit të Administratës Pensionale të Kosovës, duke bërë pretendimin ankimor se organi i sipërpërmendur administrativ, kishte zbatuar gabimisht të drejtën materiale dhe kishte vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë gjendjen faktike, duke mos marrë parasysh faktet se gjendja e tij shëndetësore është e rëndë dhe paaftësinë e tij për punë.*

*Departamenti i Administratës Pensionale refuzoi të ndajë pensionin invalidor paditësit për shkak se komisioni i mjekësor kishte vlerësuar se te paditësi nuk ekziston aftësia e kufizuar e plotë dhe e përhershme.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se si organi i shkallës së parë ashtu edhe ai i shkallës së dytë gjatë vërtetimit të gjendjes faktike, në mënyrë të drejtë dhe të plotë kanë zbatuar dispozitat e procedurës së përgjithshme administrative dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se paditësi nuk i ka përmbushur kriteret e parashikuara me nenin 3 të Ligjit nr. 2003/23 mbi Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e paditësit është e pabazuar.*

A.nr.148/2005

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Vjosa Nimani-Zylfiu, kryetare, Osman Tmava dhe Shahdane Agani, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Ajna Gashi, procesmbajtëse, në kontestin administrativ sipas padisë së paditësit A.L., kundër anës së paditur Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale Këshilli i ankesave për pensionet invalidore Prishtinë, për anulimin e aktvendimit të shkallës së dytë nr.5007881 datë 20.12.2004, në seancën e mbajtur më 27.07.2005, mori këtë

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet padia.

**A r s y e t i m i**

Me aktvendimin e kontestuar është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit, e paraqitur kundër vendimit të Departamentit të Administratës Pensionale të Kosovës nr. 5007881 datë 08.10.2004, me të cilin është refuzuar kërkesa që paditësit t'i njihet e drejta e pensionit për persona me aftësi të kufizuara.

Paditësi në padi, me të cilën konteston ligjshmërinë e aktvendimit të shkallës së dytë, thekson se aktvendimi i anës së paditur është i paligjshëm, se komisionet mjekësore të anës së paditur nuk kanë marrë parasysh faktet se gjendja e tij shëndetësore është e rëndë, se nuk është i aftë për punë dhe se provat e prezantuara nuk i morën parasysh, për çka edhe gjendja faktike nuk u vërtetua në mënyrë të plotë dhe kjo pati për pasojë zbatimin e gabuar të së drejtës materiale në dëm të tij. Ka propozuar që padia të pranohet dhe të anulohet vendimi i kontestuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi vlerësoi aktvendimin e kontestuar në përputhje me dispozitën e parashikuar nga neni 40 par.1 të Ligjit për Kontestet Administrative (LKA), gjeti se padia nuk është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës shihet se organi i shkallës së parë me vendimin nr.5007881 datë 08.10.2004, bazuar në vlerësimin e Komisionit mjekësor, datë 28.09.2004, i cili ka vlerësuar aftësinë e kufizuar të ushtruesit të kërkesës, ka refuzuar kërkesën e paditësit për njohjen e së drejtës së pensionit të personave me aftësi të kufizuara, për arsye se Komisioni mjekësor, i cili e ka vlerësuar aftësinë e kufizuar të ushtruesit të kërkesës, ka nxjerrë përfundim se te paditësi nuk ekziston aftësia e kufizuar e plotë dhe e përhershme.

Me dispozitën e nenit 1.5 të Ligjit nr.2003/23 për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë, i shpallur me Rregulloren nr.2003/40, parashikohet se një person do të konsiderohet se është me aftësi përherë dhe plotësisht të kufizuara, nëse ka moshën më shumë se 18 vjeç dhe më pak se 65 vjeç dhe ka diagnozën mjekësore për gjendjen fizike, ndijore ose mendore, ka sëmundje ose aftësi të kufizuar që e bëjnë atë të paaftë për çfarëdo pune që shpërblehet dhe kur Ministria bën vlerësimin e personit dhe vendos se ai i përmbush kriteret e parashikuara në këtë ligj. Për të gëzuar të drejtën e pensionit të

personave me aftësi të kufizuara, gjendja shëndetësore, sëmundja apo aftësia e kufizuar duhet të tregojë se personi në kohën kur paraqet kërkesën, është plotësisht i paaftë për çfarëdo pune që shpërblehet dhe në të ardhmen. Fillimi i përkeqësimit të gjendjes shëndetësore, sëmundjes apo aftësisë së kufizuar duhet të jetë paraqitur më së paku një vit para datës së dorëzimit të kërkesës.

Me dispozitën e nenit 3 të Ligjit nr.2003/23 për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë janë paraparë kriteret për përcaktimin e aftësisë së kufizuar.

Në procedurën sipas ankesës, ana e paditur ka siguruar konstatimin dhe mendimin nr.1013174632 datë 20.12.2004, të Komisionit mjekësor të formuar nga ana e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale e në përputhje me nenin 2.2 të Ligjit nr. 2003/23 për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë, i cili Komision pajtohet me vlerësimin e Komisionit mjekësor të dhënë me datën 28.09.2004, prandaj, ana e paditur me aktvendimin e kontestuar e ka refuzuar si të pabazuar ankesën.

Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, organi i shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë kanë zbatuar drejtë dispozitat e procedurës së përgjithshme administrative dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se paditësja nuk i ka përmbushur kriteret e parashikuara me nenin 3 të Ligjit nr. 2003/23 për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë.

Nga sa u tha më lart, Gjykata Supreme e Kosovës, në përputhje me nenin 42 par. 1 të LKA, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, PRISHTINË

A.nr.148/2005, më 27.07.2005

Procesmbajtësja,  
Ajna Gashi,

Kryetare e kolegjit,  
Vjosa Nimani-Zylfiu

**[Gjykata Supreme Duke vendosur mbi Konfliktin Administrativ- ankesa e refuzuar - kriteret për fitimin e të drejtës për ndihmë sociale - Rregullorja e UNMIK-ut 2003/28 - Neni 40 (1) LKA]**

*Paditësi paraqiti ankesë kundër vendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale Departamenti i Mirëqenies Sociale në Prishtinë, duke bërë pretendimin ankimor se organi i sipërpërmendur administrativ, kishte zbatuar gabimisht të drejtën materiale dhe kishte vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë gjendjen faktike, duke mos marrë parasysh gjendjen e rëndë ekonomike të paditësit.*

*Qendra për Punë Sociale në Pejë refuzoi ti ndajë ndihmë sociale paditesit për shkak se ai nuk kishte përmbushur kriteret për ndarjen e ndihmës sociale.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se organi i shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë kishin vërtetuar se familja e paditesit nuk kishte përmbushur kriteret për ndarjen e ndihmës sociale për shkak se është gjetur se familja e paditësit ka anëtar të aftë për punë dhe veprimtari ekonomike siç parashihet me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/28 mbi Skemën e Ndihmës Sociale. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e paditësit ishte e pabazë.*

A.nr.201/2004

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Osman Tmava, kryetar, Vjosa Nimani-Zylfiu dhe Shahdane Agani, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale, Ajna Gashi, procesmbajtëse, në kontestin administrativ sipas padisë së paditësit R.M., nga Peja, kundër aktvendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale- Departamenti i Mirëqenies Sociale në Prishtinë nr.379 të datës 25.02.2005, në lëndën e ndihmës sociale, në seancën jopublike të kolegjit të mbajtur më datë 26.07.2005, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet padia.

## A r s y e t i m i

Me aktvendimin e kontestuar është refuzuar ankesa e paditësit kundër aktvendimit të Qendrës për Punë Sociale në Pejë numër 17-2526, i datës 12.012.2004, me të cilin nuk i pranohet e drejta në ndihmë sociale për arsye se familja e paditësit nuk paraqet rast social.

Paditësi, me padi, konteston ligjshmërinë e aktvendimit të atakuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, duke pohuar se paditësi dhe bashkëshortja e tij nuk janë të punësuar, jeton me 6 (gjashtë) fëmijë, tre prej të cilëve janë madhorë, mirëpo asnjëri nga ata nuk punon, në kushte të rënda ekonomike pa kurrfarë burimi të ardhurave. Propozon që padia të aprovohet e aktvendimi i kontestuar të anulohet.

Organi i paditur nuk ka dhënë përgjigje në padi.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në drejtim të theksimeve të padisë dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatoi se:

Padia është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se organet administrative në procedurën e zhvilluar administrative, me rastin e verifikimit se a i përmbush paditësi kushtet e parashikuara me Rregulloren e UNMIK-ut nr.2003/28 datë 18 gusht 2003, për Skemën e Ndhmës Sociale, kanë konstatuar se familja e paditësit nuk paraqet rast të nevojës sociale, sepse familja e paditësit ka anëtarë të aftë për punë dhe veprimtari ekonomike.

Instituti i paditur, në procedurën sipas ankesës me aktvendimin e kontestuar, e ka pranuar në tërësi gjendjen e vërtetuar faktike dhe qëndrimin juridik të organit të faktit-shkallës së parë, për çka ka refuzuar ankesën dhe ka lënë në fuqi aktvendimin e kundërshtuar.

Rregullorja e UNMIK-ut nr.2003/28 datë 18 gusht 2003, për Skemën e Ndhmës Sociale, në nenin 1 përcakton se familja e rrezikuar në aspektin social është ajo familje që përzgjidhet për ndihmë sociale.

Në nenin 4, pika 1, kjo rregullore parasheh se, për të fituar të drejtën në ndihmë sociale, të gjithë anëtarët e familjes duhet të jenë banorë të përhershëm të Kosovës dhe t'i plotësojnë kushtet për kategorizim në njëren prej kategorive vijuese: (a) kategoria e parë e cila në bazë të nenit 2 pika 7 të rregullores nënkupton familjen në të cilën të gjithë anëtarët janë të varur, përkatësisht janë të paaftë për punë shpërblyese dhe (b) kategoria e dytë-familja e cila ka një anëtar të aftë për punë dhe të paktën një fëmijë nën moshën 5 vjeçare apo që nën përkujdesje ka një jetim nën moshën 15 vjeçare ose duhet të jenë të varur në kuptim të nenit 2.7 të kësaj rregullore.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme konkludon, se organi i faktit dhe ai i paditur kanë vërtetuar se familja e paditësit nuk i plotëson kushtet ligjore të parashikuara për njohjen e së drejtës së ndihmës sociale, sepse familja e paditësit ka anëtarë të aftë për punë dhe veprimtari ekonomike si bashkëshorten Z. dhe vajzat: L., M. dhe V., njëherit edhe vetë paditësi është i aftë për punë dhe veprimtari ekonomike.

Lidhur me këtë, gjykata konstaton se në këtë çështje administrative drejtë është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cënuar ligji në dëm të paditësit, prandaj theksimet e padisë nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendjeje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga ana e organeve administrative, kështu që, në vështrim të nenit 42 par.2 të LKA, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, PRISHTINË

A.nr.201/2005, më 26.07.2005

Procesmbajtësja,  
Ajna Gashi

Kryetari i kolegjit,  
Osman Tmava

**[Gykata Supreme - duke vendosur mbi Konfliktin Administrativ ankesa e pranuar e drejta për pension invalidor - neni 40 (1) LKA - neni 2.2 Ligji Nr. 2003/23 mbi Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë neni 61 LKA]**

*Paditësi paraqiti ankesë kundër vendimit të Departamentit të Administratës Pensionale të Kosovës, duke bërë pretendimin ankimor se organi i sipërpërmendur administrativ kishte zbatuar gabimisht të drejtën materiale dhe kishte vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë gjendjen faktike, duke mos marrë parasysh gjendjen e rëndë shëndetësore dhe paaftësin e paditësit për punë.*

*Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës refuzoi të ndajë pensionin invalidor paditësit për shkak se komisioni mjekësor kishte vlerësuar se te paditësi nuk ekziston aftësia e kufizuar.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se me aktvendimin e kontestuar është cënuar ligji në dëm të paditësit sepse vendimi është marrë pa u vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë të gjitha faktet relevante në këtë lëndë. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e paditësit është e bazuar.*

A.nr.233/2005

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Osman Tmava, kryetar, Meleqe Behxheti dhe Vjosa Nimani-Zylfiu anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Ajna Gashi, procesmbajtëse, në kontestin administrativ sipas padisë së paditëses H.R., nga Gjilani, kundër aktvendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale Këshilli i ankesave për pensionet e personave me aftësi të kufizuar, Prishtinë, nr.5001016 datë 04.12.2004, në lëndën e pensionit, në seancën e mbajtur më 26.07.2005, mori këtë

## A K T G J Y K I M

PRANOHET padia.

Anulohet aktvendimi i Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës-Këshilli i ankesave për pensionet e personave me aftësi të kufizuar, Prishtinë, nr.5001016 datë 04.12.2004.

## A r s y e t i m i

Me aktvendimin e kontestuar është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditëses, paraqitur kundër vendimit të Departamentit të Administratës Pensionale të Kosovës nr. 5015313 datë 26.11.2004, me të cilin është refuzuar kërkesa që paditëses t'i njihet e drejta e pensionit për persona me aftësi të kufizuara.

Paditësja në padi, me të cilën konteston ligjshmërinë e aktvendimit të shkallës së dytë, thekson se aktvendimi i kontestuar është i paligjshëm, sepse komisionet mjekësore të paditurës nuk kanë marrë parasysh faktet, se gjendja shëndetësore e paditëses është e rëndë, se ajo nuk është e aftë për punë, se provat e prezantuara nuk janë marrë parasysh, për çka edhe gjendja e fakteve nuk u vërtetua në mënyrë të plotë dhe kjo kishte për pasojë zbatimin e gabuar të së drejtës materiale në dëm të saj. Ka propozuar që padia të pranohet dhe të anulohet aktvendimi i kontestuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi vlerësoi aktvendimin e kontestuar në përputhje me dispozitën e parashikuar nga neni 40 par. 1 të Ligjit për Kontestet Administrative (LKA), gjeti se padia është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës shihet se organi i shkallës së parë, me vendimin nr. 5001016 datë 12.08.2004, e ka refuzuar kërkesën e paditëses për njohjen e së drejtës në pension për personat me aftësi të kufizuara. Komisioni mjekësor, i cili e ka vlerësuar aftësinë e kufizuar të ushtrueses së kërkesës, më 05.08.2004, ka konstatuar se te paditësja ekziston aftësia e kufizuar e plotë dhe e përhershme.

Në procedurën sipas ankesës, organi shkallës së dytë, ka siguruar konstatimin dhe mendimin nr.1002996185 datë 04.12.2004, të Komisionit mjekësor të formuar nga ana e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në përputhje me nenin 2.2 të Ligjit për Pensionet e

Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë, i cili Komision ka konstatuar se te paditësja nuk ekziston paaftësia e kufizuar, dhe për këtë arsye me aktvendimin e kontestuar e ka refuzuar si të pabazuar ankesën.

Gjykata konkludon që në këtë çështje administrative ekzistojnë kundërthënie të cilat nuk janë evituar gjatë vendosjes nga ana e organit të shkallës së parë dhe atij të paditur sepse nuk janë vlerësuar provat në shkresat e lëndës, përkatësisht në konstatimet dhe mendimet e komisioneve mjekësore të organeve administrative ekziston kundërthënie lidhur me faktin se tek paditësja a ekziston aftësia e kufizuar. Në këtë kontekst komisioni mjekësor i shkallës së parë konstaton se te paditësja ekziston aftësia e kufizuar ndërsa komisioni mjekësor i shkallës së dytë konstaton se nuk ekziston aftësia e kufizuar te paditësja.

Nga këto arsye gjykata konstaton se me aktvendimin e kontestuar është cënuar ligji në dëm të paditëses sepse është marrë pa u vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë të gjitha provat relevante në këtë lëndë, çka do të thotë në gjendje të pavërtetuar faktike duke mos e evituar kontradiktoriteti në mes provave që i prezantoi paditësja, konstatimeve të komisioneve mjekësore edhe provave në të cilat bazohet aktvendimi, lidhur me të drejtën e kërkuar nga e cila paditësja është refuzuar.

Në këtë drejtim, gjykata e obligon organin e paditur që në riprocedurë të veprojë sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim duke pasur parasysh që nuk janë vlerësuar në mënyrë të drejtë të gjitha faktet relevante të cilat kishin me ndikuar në vendosjen e drejtë dhe të ligjshme të kësaj çështje administrative neni 61 i LKA.

Me sa u cek më lart, gjykata në vështrim të nenit 39 par.2 dhe nenit 42 par 2 të LKA, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, PRISHTINË  
A.nr.233/2005, më 26.07.2005

Procesmbajtësja,  
Ajna Gashi

Kryetari i kolegjit,  
Osman Tmava

**[Gjykata Supreme Duke vendosur mbi Konfliktin Administrativ- ankesa e pranuar - kriteret për fitimin e të drejtës për pension invalidor - neni 40 (1) LKA neni 61 LKA]**

*Paditësi paraqiti ankesë kundër vendimit të Departamentit Administratës Pensionale të Kosovës, duke bërë pretendimin ankimor se organi i sipërpërmendur administrativ, kishte zbatuar gabimisht të drejtën materiale dhe kishte vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë gjendjen faktike, duke mos marrë parasysh gjendjen e rëndë shëndetsore dhe paaftësinë e paditësit për të punuar.*

*Departamenti i Administratës Pensionale refuzoi të ndajë pensionin invalidor paditësit për shkak se komisioni i mjekëve kishte vlerësuar se te paditësi nuk ekziston aftësia e kufizuar.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se me aktvendimin e kontestuar është cënuar ligji në dëm të paditësit sepse është marrë pa u vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë të gjitha provat relevante në këtë lëndë. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e paditësit është e bazuar.*

A.nr.264/2005

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Osman Tmava, kryetar, Shahdane Agani dhe Vjosa Nimani-Zylfiu, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Ajna Gashi, procesmbajtëse, në kontestin administrativ sipas padisë së paditësit E.K., nga fshati Lladovc, komuna e Podujevës, kundër aktvendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale Këshilli i ankesave për pensionet e personave me aftësi të kufizuar, nr.5010697 datë 12.02.2005, në lëndën e pensionit, në seancën jopublike të mbajtur më datën 26.07.2005, mori këtë

## A K T G J Y K I M

PRANOHET padia.

Anulohet aktvendimi i Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës-Këshilli i

ankesave për pensionet e personave me aftësi të kufizuar, Prishtinë, nr.5010697 datë 12.02.2005.

### A r s y e t i m i

Me aktvendimin e kontestuar është refuzuar si e pabazë ankesa e paditësit e paraqitur kundër vendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës, në Prishtinë, nr 5010679 datë 02.11.2004, me të cilën është refuzuar kërkesa që paditësit t'i njihet e drejta për pension me aftësi të kufizuar.

Paditësi me padi konteston ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar, duke pohuar se komisionet mjekësore të paditurës, nuk morën parasysh faktet se gjendja e tij shëndetësore është e rëndë, se nuk është i aftë për punë dhe provat e prezantuara nuk janë marrë parasysh, për çka edhe gjendja e fakteve nuk u vërtetua në mënyrë të plotë dhe kjo kishte për pasojë zbatimin e gabuar të së drejtës materiale në dëm të tij. Propozon që padia të aprovohet dhe të anulohet aktvendimi i kontestuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të vendimit të kontestuar sipas nenit 40 par.1 të Ligjit të Kontesteve Administrative (LKA), vlerësimi të thënieve në padi dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se:

Padia është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës shihet se organi i shkallës së parë me vendimin nr.5010697 datë 02.11.2004, ka refuzuar kërkesën e paditësit për njohjen e së drejtës në pension. Komisioni mjekësor më datë 22.10.2004, ka vlerësuar aftësi psiko-fizike-punuese të ushtruesit së kërkesës, për çka ka nxjerrë përfundimin se te paditësi nuk ekziston aftësia e kufizuar (e plotë dhe e përhershme).

Gjykata konkludon që në këtë çështje administrative ekzistojnë kundërthënie të cilat nuk janë evituar gjatë vendosjes nga ana e organit të shkallës së parë dhe atij të paditur sepse nuk janë marrë parasysh provat në shkresat e lëndës (Aktvendimi i BVI-it të Sigurimit Pensional

e Invalidor të Ksovës, nr. 7320470304, Prishtinë datë 19.09.1989, lidhur me të drejtën e kërkuar në pension invalidor. Konstatohet se paditësi është shfrytëzues i pensionit invalidor).

Nga këto arsye gjykata konstaton se me aktvendimin e kontestuar është cenuar ligji në dëm të paditësit sepse është marrë pa u vlerësuar në mënyrë të drejtë të gjitha provat relevante në këtë lëndë, çka do të thotë në gjendje të pavërtetuar faktike duke mos e evituar kontradiktoriteti në mes provave që i prezantoi paditësi dhe provat në të cilat bazohet aktvendimi i kontestuar, e lidhur me të drejtën e kërkuar nga e cila paditësi është refuzuar.

Në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur që në riprocedurë të veprojë sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim duke pasur parasysh që nuk janë vlerësuar në mënyrë të drejtë të gjitha faktet relevante të cilat kishin me ndikuar në vendosjen e drejtë dhe të ligjshme të kësaj çështje administrative neni 61 i LKA.

Me sa u cek më lart, gjykata në vështrim të nenit 39 par.2 dhe nenit 42 par.2 të LKA, u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, PRISHTINË  
A.nr.264/2005, më 26.07.2005

Procesmbajtësja,  
Ajna Gashi

Kryetari i kolegjit,  
Osman Tmava

**[Gykata Supreme duke vendosur mbi Konfliktin Administrativ ankesa e pranuar e drejta për pension invalidor- neni 40 (1) LKA - neni 2.2 Ligji Nr. 2003/23 mbi Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë]**

*Paditësi paraqiti ankesë kundër vendimit të Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës, duke bërë pretendimin ankimor se organi i sipërpërmendur administrativ kishte zbatuar gabimisht të drejtën materiale dhe kishte vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë gjendjen faktike, duke mos marrë parasysh faktet se gjendja e tij shëndetësore është e rëndë dhe paaftësinë e tij për punë.*

*Departamenti i Administratës Pensionale refuzoi të ndajë pensionin invalidor paditësit për shkak se komisioni mjekësor kishte vlerësuar se te paditësi nuk ekziston aftësia e kufizuar e plotë dhe e përhershme.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se vendimi i ankimuar përmban të meta të tilla që e bëjnë të pamundur shqyrtimin e ligjshmërisë së tij. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e paditësit është e bazuar.*

A.nr.289/2005

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Vjosa Nimani-Zylfiu, kryetare, Osman Tmava dhe Meleqe Behxheti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Ajna Gashi, procesmbajtëse, në kontestimin administrativ sipas padisë së paditësit S.K., nga fshati Malësi e Vogël, komuna e Rahovecit, kundër anës së paditur të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale - Këshilli i ankesave për pensionet e personave me aftësi të kufizuar, Prishtinë, për anulimin e aktvendimit të shkallës së dytë nr.5013246 datë 17.02.2005, në seancën e mbajtur më 22.08.2005, mori këtë

**A K T G J Y K I M**

**PRANOHET** padia.

Anulohet aktvendimi i Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale-Këshilli i ankesave për pensionet e personave me aftësi të kufizuar, Prishtinë, 5013246 datë 17.02.2005.

**A r s y e t i m i**

Me aktvendimin e kontestuar është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit, paraqitur kundër vendimit të Departamentit të Administratës Pensionale të Kosovës nr. 5013246 datë 21.10.2004, me të cilin është refuzuar kërkesa që paditësit t'i njihet e drejta e pensionit për persona me aftësi të kufizuara.

Paditësi në padi, me të cilën konteston ligjshmërinë e aktvendimit të shkallës së dytë, thekson se aktvendimi i kontestuar është i paligjshëm, sepse komisionet mjekësore të paditurës nuk kanë marrë parasysh faktet, se gjendja shëndetësore e paditësit është e rëndë, se ai nuk është i aftë për punë, se provat e prezantuara nuk u morën parasysh, për çka edhe gjendja faktike nuk u vërtetua në mënyrë të plotë dhe kjo pati për pasojë zbatimin e gabuar të së drejtës materiale në dëm të tij. Ka propozuar që padia të pranohet dhe të anulohet vendimi i kontestuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi vlerësoi aktvendimin e kontestuar në përputhje me dispozitën e parashikuar nga neni 40 par. 1 të Ligjit për Kontestet Administrative (LKA), gjeti se padia është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës shihet se organi i shkallës së parë, me vendimin nr.5013246 datë 21.10.2004, e ka refuzuar kërkesën e paditësit për njohjen e së drejtës së pensionit të personave me aftësi të kufizuara. Komisioni mjekësor, i cili e ka vlerësuar aftësinë e kufizuar të ushtruesit të kërkesës, më 14.10.2004, ka nxjerrë përfundimin se te paditësi nuk ekziston aftësia e kufizuar e plotë dhe e përhershme.

Në procedurën sipas ankesës, organi shkallës së dytë, ka siguruar konstatimin dhe mendimin nr.5013246, datë 17.02.2005, të Komisionit mjekësor të formuar nga ana e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në përputhje me nenin 2.2 të Ligjit për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë, i cili Komision ka konstatuar se te paditësi nuk ekziston paaftësia, dhe për këtë arsye me vendimin e kontestuar i ka refuzuar si të pabazuar ankesën.

Nga aktvendimi i kontestuar del se ky përmban të meta të tilla që e bëjnë të pamundur shqyrtimin e ligjshmërisë së tij.

Gjykata për kontest, si rregull, vendos në bazë të fakteve të cilat janë vërtetuar në procedurën administrative. Gjykata Supreme vlerëson se ky kontest nuk mund të shqyrtohet në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative, ngase për faktet e vërtetuara ekzistojnë kundërthënie në shkresat e lëndës. Me aktvendimin e Bashkësisë Vetëqeverisëse të Interesit Sigurimi Pensional e Invalidor të Kosovës (Drejtoria në Prizren) nr.7018594498 datë 05.10.1985, është konstatuar se paditësi ka qenë shfrytëzues i pensionit invalidor, njëherit ka qenë edhe invalid ushtarak. Komisioni i organit të shkallës së parë ka vërtetuar se paditësi ka aftësi të kufizuar të përhershme. Arsytimi i aktvendimit të kontestuar nuk përmban arsye përkitazi me thëniet ankimore të paditësit të paraqitura në ankesën e ushtruar kundër vendimit të organit të shkallës së parë dhe as për rrjedhën e procedurës së zhvilluar pranë organit të shkallës së dytë.

Të metat e sipërpërmendura janë të natyrës së tillë që nuk mundësojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit të kontestuar, prandaj me zbatimin e neneve 39 par 2 të LKA, aktvendimi i kontestuar, u desh të anulohet.

Në riprocedurë të metat e sipërpërmendura duhet të mënjanohen e pastaj të merret një vendim i ligjshëm.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, PRISHTINË  
A.nr.289/2005, më 22.08.2005

Procesmbajtëja,  
Ajna Gashi

Kryetarja e kolegjit,  
Vjosa Nimani-Zylfiu

**[Gjykata Supreme duke vendosur mbi Konfliktin Administrativ ankesa e refuzuar TVSH - neni 40 (1) Rregullorja e UNMIK-ut nr.2000/20 mbi administratën dhe procedurën tatimore - 2, (2), (12) LKA]**

*Paditësi, Administrata Tatimore e Kosovës Zyra Regjionale në Prizren paraqiti ankesë kundër vendimit të Bordit të Pavarur për Rishqyrtime duke bërë pretendim ankimor se organi i sipërpërmendur administrativ kishte vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë gjendjen faktike dhe kishte zbatuar gabimisht të drejtën materiale.*

*Bordi i Pavarur për Rishqyrtime në Prishtinë kishte korrigjuar shumën e TVSH-së që duheshte paguar nga i padituri.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se me vendimin e kontestuar paditëses nuk i është cënuar asnjë e drejtë apo interes i drejtpërdrejtë i bazuar në ligj, ngase ajo nuk mund të jetë bartëse (titullare) e së drejtës apo detyrimit për të cilin është vendosur në procedurën e zhvilluar administrative të parashikuar nga neni 2 paragrafi 2 dhe neni 12 i LKA dhe Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/20 mbi administratën dhe procedurën tatimore. Prandaj Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e paditësit është e pabazuar.*

A.nr.333/2003

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Osman Tmava, kryetar, Meleqe Behxheti e Vjosa Nimani-Zylfiu, anëtare, me bashkëpunëtoren profesionale Ajna Gashi, procesmbajtëse, në kontestin administrativ sipas padisë së paditëses Administrata Tamitore e Kosovës -Zyra regjionale në Prizren, kundër vendimit të Bordit të pavarur për rishqyrtime në Prishtinë nr.63/2003 datë 07.07.2003, në lëndën e tatimit, në seancën e mbajtur me datë 21.06.2005, mori

A K T V E N D I M

Hidhet poshtë padia.

A r s y e t i m i

Me vendimin e kontestuar, nr.63/2003 datë 07.07.2003, Bordi i pavarur për rishqyrtime në Prishtinë, pjesërisht ka pranuar si të bazuar ankesën e palës NPT “Pisha” me seli në Prizren, të paraqitur kundër vendimit të paditëses (Departamentit të ankesave) nr.251 datë 20.12.2002, ashtu që ka bërë korigjimin e Tatimit në vlerën e shtuar për muajin 07/02 në vlerën prej 40.608,73 €, për të cilën vlerë pala është liruar nga detyrimi i pagimit të tatimit shtesë.

Paditësja në padinë e paraqitur kundërshton ligjshmërinë e vendimit të kontestuar duke theksuar se gjendja e fakteve nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, se ligji është zbatuar në mënyrë të gabuar, ndërsa vendimi i kontestuar është edhe kontradiktor për arsye se dispozitivi i tij është në kundërshtim me provat në lëndë dhe arsyet e dhëna. Propozon që padia të aprovohet dhe vendimi i kontestuar të anulohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, vendimin e kontestuar e vlerësoi sipas nenit 40 të Ligjit për Kontestet Administrative (LKA) dhe pas vlerësimit të thënieve në padi dhe shkresave të lëndës ka gjetur se:

Padia nuk është e lejueshme.

Nga shkresat në lëndë del se me vendimin e paditëses (Departamentit të ankesave), nr.251 datë 20.12.2002, pala- NPT “Pisha” me seli në Prizren, është obliguar të paguajë Tatimin në vlerën e shtuar për muajin 07/02 dhe sipas ankesës së palës tatim paguesit organi administrativ i paditur me vendimin e kontestuar e pranon pjesërisht ankesën e palës, bën korigjimin në vlerësimin e Tatimit për vlerën e shtuar kështu që për muajin 07/02, palën NPT “Pisha”, e obligon të paguajë tatimin e cekur për vlerën prej 40.608,73 €.

Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e RSFJ nr.47 datë 16 gusht 1985-LPPA), në nenin 1 par.1 parashef se organet e administratës zbatojnë dispozitat e atij ligji kur vendosin në çështjet administrative për ndonjë të drejtë, detyrim apo interes juridik të personit fizik apo juridik .

Në këtë drejtim edhe Rregullorja e UNMIK-ut nr.2000/20 datë 12 prill 2000 mbi administratën dhe procedurën tatimore, në nenin 7 par.1 parashef se tatim paguesi i cili mendon se ju është cënuar ndonjë e drejtë ka mundësi të bëjë kërkesë për rishqyrtim të vendimit të

administratës tatimore (përcaktimi zyrtar) në Departamentin e Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës.

Në kuptim të nenit 2 par.2 dhe neni 12 të LKA, rezulton se organet shtetërore edhe pse nuk e kanë cilësinë e personit juridik mund të inicojnë kontestin administrativ nëse mund të jenë bartës (titullarë) të drejtave dhe detyrimeve për të cilat është vendosur në procedurën adminisitrative apo nëse atyre u është cënuar ndonjë interes i drejtëpërdrejtë i bazuar në ligj.

Gjykata Supreme e Kosovës, në rastin konkret vlerëson se paditësja në kuptim të dispozitave të sipër cekura ligjore të LPPA dhe Rregullores së UNMIK-ut nr.2000/20 datë 20 prill 2000, mbi administratën dhe procedurën tatimore, me rastin e vendosjes sipas kërkesës së palës për rishqyrtim të vlerësimit zyrtar, ka zbatuar procedurë dhe ka vlerësuar zbatimin e dispozitave ligjore të cilat kanë të bëjnë me caktim të një detyrimi për palën tatim paguesin, ndërsa me vendimin e kontestuar vlerësohet se paditëses nuk i është cënuar asnjë e drejtë apo interes i drejtëpërdrejtë sepse ajo nuk mund të jetë bartëse (titullare) e të drejtës apo detyrimit për të cilën është vendosur në procedurën e zhvilluar administrative, në kuptim të dispozitave të sipërcekura të LKA.

Nga këto arsye, Gjykata Supreme e Kosovës, me zbatimin e nenit 30 par.1 pika 3 të LKA, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, PRISHTINË  
A.nr.333/2003, më 21.06.2005

Procesmbajtësja,  
Ajna Gashi

Kryetari i kolegjit,  
Osman Tmava

**[Gjykata Supreme duke vendosur mbi Konfliktin Administrativ - ankesa e refuzuar - kriteret për fitimin e të drejtës për ndihmë sociale - Rregullorja e UNMIK-ut 2003/28 - Neni 40 (1) LKA]**

*Paditësi paraqiti ankesë kundër vendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale Komisioni për Ankesa në Prishtinë, duke bërë pretendimin ankimor se organi i sipërpërmendur administrativ, kishte zbatuar gabimisht të drejtën materiale dhe kishte vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë gjendjen faktike,, duke mos marrë parasysht gjendjen e rëndë ekonomike të paditësit.*

*Qendra për Punë Sociale në Pejë refuzoi ti ndajë ndihmë sociale paditësit për shkak se ai nuk kishte përmbushur kriteret për ndarjen e ndihmës sociale.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se organi i shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë kishin vërtetuar se familja e paditësit nuk i kishte përmbushur kriteret për ndarjen e ndihmës sociale për shkak se është gjetur se familja e paditësit ka anëtarë të aftë për punë dhe veprimtari ekonomike siç parashihet me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/28 mbi Skemën e Ndihmës Sociale. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e paditësit ishte e pabazuar.*

A.nr.356/2005

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Vjosa Nimani Zyfliu, kryetare, Osman Tmava dhe Meleqe Behxheti, anëtarë, procesmbajtëse Ajna Gashi, bashkëpunëtoresh profesionale, lidhur me kontestin administrativ sipas padisë së paditësit M.F., nga Vitimirica, komuna e Pejës, kundër anës së paditur Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale - Komisioni për Ankesa Prishtinë, për anulimin e vendimit të shkallës së dytë nr.452 datë 08.04.2005, në lëndën e ndihmës sociale, në seancën jopublike të kolegjit të mbajtur më datë 20.09.2005, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet padia.

**A r s y e t i m i**

Me aktvendimin e kontestuar është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit, paraqitur kundër aktvendimit të Qendrës për Punë Sociale në Pejë nr.17-04076 datë 17.01.2005, me të cilin është vërtetuar aktvendimi i organit të shkallës së parë, me të cilin paditësi i është ndërprerë e drejta e ndihmës sociale për arsye se familja e paditësit nuk paraqet rast social.

Paditësi me padi konteston aktvendimin e goditur, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, duke pohuar se paditësi nuk është i punësuar, jeton me bashkëshorten e sëmurë, të paaftë për punë dhe katër fëmijë, në kushte të rënda ekonomike pa kurrfarë burimi të të ardhurave. Propozon që padia të aprovohet dhe aktvendimi i kontestuar të anulohet.

Ana e paditur nuk ka paraqitur përgjigje në padi.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në drejtim të pretendimeve të padisë dhe, në përputhje me dispozitën e parashikuar nga neni 40 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Padia është e pabazuar.

Rregullorja e UNMIK-ut nr.2003/28, datë 18 gusht 2003, për Skemën e Ndihmës Sociale, në nenin 4 pika 1 parashikon se, për të fituar të drejtën e ndihmës sociale, të gjithë anëtarët e familjes duhet të jenë banorë të përhershëm të Kosovës dhe t'i plotësojnë kushtet për kategorizim në njërin prej kategorive vijuese: (a) kategoria e parë, e cila në bazë të nenit 2 pika 7 të Rregullores nënkupton familjen, në të cilën të gjithë anëtarët janë të varur dhe asnjëri prej tyre nuk është i punësuar, (b) kategoria e dytë - familja e cila ka një anëtar të aftë për punë dhe të paktën një fëmijë nën moshën 5 vjeçare apo që nën përkujdesje ka një jetim nën moshën 15 vjeç ose të gjithë anëtarët e familjes duhet të jenë të varur sipas përkufizimit të nenit 2.7 të Rregullores së sipërpërmendur ose të jenë të regjistruar si të papunësuar në Zyrat e Punësimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Nga shkresat e lëndës shihet se organet administrative në procedurën e zhvilluar administrative, me rastin e verifikimit se a i përmbush paditësi kushtet për të fituar të drejtën e ndihmës sociale të parashikuara me Rregulloren e UNMIK-ut nr.2003/28 datë 18 gusht 2003, për Skemën e Ndhmës Sociale, kanë konstatuar se familja e paditësit nuk i plotëson kriteret e parashikuara në skemën e sipërpërmendur për të përfituar ndihmën sociale.

Ana e paditur, në procedurën sipas ankesës, me aktvendimin e kontestuar e ka pranuar në tërësi gjendjen e vërtetuar faktike dhe qëndrimin juridik të organit të shkallës së parë dhe, duke pasur parasysh se familja e paditësit ka anëtarë të aftë për punë dhe veprimtari ekonomike siç është bashkëshortja e tij H. dhe vetë paditësi, ka refuzuar ankesën dhe ka lënë në fuqi aktvendimin e kundërshtuar.

Gjykata vlerëson se në këtë çështje administrative është vërtetuar drejt gjendja faktike, nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, kështu që, në përputhje me nenin 42 par.2 të LKA, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, PRISHTINË  
A.nr.356/2005, më 20.09.2005

Procesmbajtësja,  
Ajna Gashi

Kryetarja e kolegjit,  
Vjosa NimaniZylfiu

**[Gjykata Supreme duke vendosur mbi Konfliktin Administrativ ankesa e refuzuar TVSH - neni 40 (1) LKA - Rregullorja e UNMIK-ut nr.2000/20 mbi administratën dhe procedurën tatimore - neni 2, (2), (12) LKA]**

*Paditësi, Administrata Tatimore e Kosovës paraqiti ankesë kundër vendimit të Bordit të Pavarur për Rishqyrtime në Prishtinë, duke bërë pretendim ankimor se organi i sipërpërmendur administrativ, kishte zbatuar gabimisht të drejtën materiale dhe kishte vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë gjendjen faktike.*

*Bordi i Pavarur për Rishqyrtime në Prishtinë kishte eliminuar nga baza për llogaritjen e tatimeve furnizimet sipas dokumentave unike doganore, të cilat i përkasin tatim paguesit tjetër.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se me vendimin e kontestuar paditëses nuk i është cënuar asnjë e drejtë apo interes i drejtpërdrejtë i bazuar në ligj, ngase ajo nuk mund të jetë bartëse (titullar) e së drejtës apo detyrimit për të cilin është vendosur në procedurën e zhvilluar administrative të parashikuar nga neni 2 paragrafi 2 dhe meni 12 i LKA dhe Rregullorja e UNMIK-ut nr.2000/20 mbi administratën dhe procedurën tatimore. Prandaj Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e paditësit është e pabazuar.*

A.nr.373/2003

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Vjosa Nimani-Zylfiu, kryetare, Osman Tmava dhe Meleq Behxheti, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Ajna Gashi, procesmbajtëse, në çështjen juridike të paditëses Administrata Tatimore, Prishtinë, kundër anës së paditur Bordi i Pavarur për Rishqyrtime, përkitazi me padinë e paditëses për anulimin e vendimit të anës së paditur nr.90/2003 datë 12.9.2003, në seancën jopublike të mbajtur më 21.7.2005, mori

A K T V E N D I M

Hidhet poshtë padia.

## A r s y e t i m i

Bordi i Pavarur për Rishqyrtime në Prishtinë, duke vendosur për ankesën e NTP "BUJARI" nga Ferizaj e ka ndryshuar pjesërisht vendimin e Administratës Tatimore Departamenti i ankesave në Prishtinë nr.17, datë 19.02.2003, ashtu tatimpaguesit ia ka eliminuar nga baza për llogaritjen e tatimeve (tatimit të paragjykuar dhe tatimit në vlerën e shtuar) furnizimet sipas dokumentave unike doganore 14439,14387, 403,438, të cilët i përkasin tatimpaguesit tjetër.

Këtë vendim paditësja e ka kontestuar me padi, për shkak të shkeljeve thelbësore të Rregullave të Procedurës Administrative, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Ka propozuar që Gjykata Supreme ta aprovojë padinë, vendimin e kontestuar ta anulojë dhe lëndën t'ia kthejë për rishqyrtim organit të shkallës së dytë.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi që, në përputhje me dispozitën e nenit 40 par. 1 të Ligjit për Kontestet Administrative (LKA), vlerësoi aktvendimin e kontestuar, thëniet në padi, të gjitha shkresat e lëndës së kësaj çështjeje juridiko-administrative, gjeti se:

Padia nuk është e lejueshme.

Me dispozitën e nenit 12 të LKA parashikohet se paditës në procedurën e konfliktit administrativ mund të jetë individi, personi juridik, organizata, grupi i qytetarëve etj., që konsideron se me aktin administrativ i është cënuar ndonjë e drejtë ose interes i drejtpërdrejtë i bazuar në ligj.

Me dispozitën e parashikuar nga neni 2 par.2 parashikohet se organet shtetërore, edhe pse nuk e kanë cilësinë e personit juridik, mund të iniciojnë kontest administrativ, nëse mund të jenë bartës të të drejtave dhe detyrimeve për të cilat është vendosur në procedurën administrative apo nëse atyre u është cënuar ndonjë interes i drejtpërdrejtë i bazuar në ligj.

Paditësja, në përputhje me dispozitat e sipër cekura të LPPA dhe në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr.2000/20 mbi Administratën dhe Procedurën Tatimore, me rastin e vendosjes mbi kërkesën e palës

për rishqyrtim të vlerësimit zyrtar, ka zbatuar procedurën dhe ka vlerësuar zbatimin e dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me caktimin e një detyrimi për tatimpaguesin. Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se me vendimin e kontestuar paditësës nuk i është cënuar asnjë e drejtë apo interes i drejtpërdrejtë i bazuar në ligj, ngase ajo nuk mund të jetë bartëse e së drejtës apo detyrimit për të cilin është vendosur në procedurën e zhvilluar administrative.

Nga sa u tha më lart dhe me zbatimin e nenit 30 par. 1 pika 3 të LKA, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, PRISHTINË  
A.nr.373/2003, më 21.07.2005

Procesmbajtësja,  
Ajna Gashi

Kryetarja e kolegjit,  
Vjosa Nimani-Zylfiu

**[Gjykata Supreme duke vendosur mbi Konfliktin Administrativ ankesa e refuzuar - uzurpimi arbitrar i tokës në pronësi shoqërore - neni 16 Ligjit mbi shqyrtimin e uzurpimeve të tokës në pronësinë shoqërore]**

*Paditësi M.L. nga Podujeva paraqiti ankesë kundër vendimit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, duke bërë pretendim ankimor se organi i sipërpërmendur administrativ, kishte zbatuar gabimisht të drejtën materiale dhe kishte vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë gjendjen faktike, duke pohuar se pjesa e ngastrës kadastrale asnjëherë nuk ka qenë pronë shoqërore, por pronë private e tij.*

*Drejtorati për gjeodezi, kadastër dhe pronë i komunës së Podujevës, ka vërtetuar se paditësi ka uzurpuar pjesën e ngastrës kadastrale me kulturë rrugë publike, e cila është pronë shoqërore dhe njëherit është obliguar ta lirojë tokën e uzurpuar dhe ta kthejë në gjendjen e mëparshme.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se autoritet administrative në mënyrë të drejtë dhe të plotë e kanë vërtetuar gjendjen faktike duke konstatuar se paluajtshmëria e cekur është uzurpuar nga ana e paditësit. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e paditësit është e pabazuar.*

A.nr.382/2003

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Osman Tmava, kryetar, Meleqe Behxheti dhe Vjosa Nimani-Zylfiu, anëtare, me bashkëpunëtoren profesionale Ajna Gashi, procesmbajtëse, në kontestin administrativ sipas padisë së paditësit M.L. nga Podujeva, kundër aktvendimit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, A.nr.146/2003 datë 11.08.2003, në lëndën e uzurpimit arbitrar të tokës në pronësinë shoqërore, në seancën e mbajtur me datën 21.06.2005, mori

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet padia.

**A r s y e t i m i**

Me aktvendimin e kontestuar është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit e është vërtetuar aktvendimi i Kryeshefit Ekzekutiv

të Komunës së Podujevës, nr.02-1/466-141 datë 29.05.2002, me të cilin refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit dhe vërtetohet aktvendimi i Drejtorisë për kadastër, gjeodezi dhe pronë i komunës së Podujevës, nr.09-466-45 datë 11.07.2001, sipas të cilit vërtetohet se paditësi ka uzurpuar pjesën e ngastrës kadastrale ne.2857, me kulturë rrugë publike, në vendin e quajtur “Te qershijat”, në sipërfaqe prej .16,00 m2, e evidencuar sipas fletës poseduese nr.1245, ZK Podujevë, e njëherit është obliguar ta lirojë tokën e uzurpuar dhe ta kthejë në gjendjen e mëparshme, në afat prej 15 ditëve pasi që aktvendimi të marrë formën e prerë.

Paditësi me padi konteston ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe nxjerrjes të konkluzionit të gabuar, duke pohuar se pjesa e ngastrës kadastrale asnjëherë nuk ka qenë pronë shoqërore me kulturë rrugë, por pasuri e tij private të cilën e ka blerë prej H.Sh., për çka edhe posedon kontratën për shitëblerje, se në posedim të asaj paluajtshëmrie është më shumë se 40 vite, se një pjesë e paluajtshmërisë është eksperoprijuar por jo edhe vendi ku ka filluar ndërtimin e objektit-lokalit afarist dhe në këtë drejtim thekson se me interes për vërtetimin e drejtë të fakteve vendimtare do të ishte edhe që si provë të nxirret dëgjimi i dëshmitarëve H.Y., B.Y. dhe M.Sh.. Propozon që padia të aprovet dhe të anulohet aktvendimi i kontestuar.

Organi administrativ i paditur në përgjegje të padisë, mbetet pranë konstatimeve të dhëna në aktvendimin e kontestuar duke propozuar që padia të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në pajtim me nenin 40 par.1 të Ligjit për Kontestet Administrative (LKA), në drejtim të theksimeve të padisë, përgjigjes në padi dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera në lëndë, konstaoti se:

Padia është e pabazuar.

Nga ana e organeve administrative është vërtetuar se pjesa e ngastrës kadastrale 2857, me kulturë rrugë publike, me sipërfaqe prej 0.16,00 m2, në vendin e quajtur “Te qershijat”, e evidentuar sipas fletës poseduese nr.1245, ZK Podujevë, në emër të pasurisë shoqërore është uzurpuar nga ana e paditësit ashtu që ka filluar ndërtimin e objektit-lokalit afarist, me material të fortë. Nga shkresat e lëndës shifet se

paditësi është marrë në pyetje me datën 15.05.2001, duke deklaruar se nuk ka filluar ndërtimin e objektit lokalit afarist në tokën në pronësinë shoqërore por në tokën të cilën e ka në pronësi private, të cilën e ka blerë nga H.Sh., për çka se posedon edhe kontratën për shitëblerje, se në posedim të asaj toke është më tepër se 40 vite ndërsa një pjesë e tokës ka qenë e eksproprijuar por jo edhe pjesa ku është duke u bërë ndërtimi i objektit-lokalit afarist.

Gjendja e këtyre faktike lidhur me uzurpimin arbitrar të tokës në pronësinë shoqërore, në ngastrën e cekur kadastrale, numër dhe sipërfaqe të lartëshënuar, me kulturë rrugë publike, pa mëdyshje është vërtetuar edhe nga ana e ekspertëve-geometër, Fatmir Gashi dhe Fitim Restelica, të cilin fakt ata e vërtetuan me datën 14 dhe 15.05.2001, dhe konstatuan në skicën-kopjen e planit të përpiluar në vendin e ngjarjes.

Në prani të fakteve jo kontestuese edhe sipas mendimit të gjykatës, organet administrative në mënyrë të drejtë dhe të plotë kanë vërtetuar gjendjen faktike, duke konstatuar se paluajtshmëria e cekur është uzurpuar nga ana e paditësit, ashtu që ka filluar ndërtimin e objektit-lokalit afarist, për çka edhe është obliguar që të njëjtën ta lirojë dhe të kthejë gjendjen e mëparme në tokën e uzurpuar, në favor të rrugës publike, në afat prej 15 ditëve pasi që aktvendimi të marrë formën e prerë, në vështrim të nenit 16 të Ligjit mbi shqyrtimin e uzurpimeve të tokës në pronësinë shoqërore (Gazeta Zyrtare e KSAK, nr.46/77) dhe nenit 6 të Ligjit mbi ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit mbi shqyrtimin e uzurpimeve të tokës në pronësinë shoqërore të krijuara me uzurpimin arbitrar (Gazeta Zyrtare e KSAK, nr.37/88), sepse u vërtetua se paditësi të njëjtën e ka uzurpuar.

Nga sa u cek më lart, gjykata konstaton se aktvendimi i kontestuar është i drejtë dhe i bazur në ligj, prandaj theksimet e padisë i vlerësoi të pandikim në vërtetimin tjetër të gjendjes faktike nga ajo e vërtetuar nga ana e organeve administrative, kështu që në vështrim të nenit 42 par.2 të LKA, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, PRISHTINË

A.nr.382/2003, më 21.06.2005

Procesmbajtëse,  
Ajna Gashi

Kryetari i kolegjit,  
Osman Tmava

**[Gykata Supreme - duke vendosur mbi Konfliktin Administrativ ankesa e refuzuar heshtja e administratës - neni 9, (1), (1) LKA - Neni 26, (1), (6) LGJR]**

*Paditësi M.L. nga Podujeva paraqiti ankesë kundër Përgjigjes me Shkrim nga Korporata Energjetike e Kosovës, Divizioni për Furnizim.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se ky rast paraqet kontest civil dhe se për gjykata kompetente për këtë është gjykata komunale në Prishtinë në bazë të nenit 9, paragrafit 1, pikës 1 të Ligjit për Kontestet Administrative. Prandaj Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e paditësit është e pabazuar.*

A.nr.392/2005

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Osman Tmava, kryetar, Vjosa Nimani-Zylfiu dhe Meleqe Behxheti, anëtare, me bashkëpunëtoren profesionale Ajna Gashi, procesmbajtëse, në kontestin administrative sipas padisë së paditëses L.R., nga Prishtina, kundër Përgjigjes me shkrim, p.nr. datë 09.05.2005, të Korporatës Energjetike të Kosovës në Prishtinë Divizioni i Furnizimit, në lëndën e heshtjes së administratës, në seancën të mbajtur me datën 29.07.2005, mori

## A K T V E N D I M

Hidhet poshtë padia.

Lënda t'i dërgohet Gjykatës Komunale në Prishtinë, si gjykatë kompetente.

## A r s y e t i m

Paditësja me padi konteston ligjshmërinë e Përgjigjes me shkrim të paditurës, p.nr. datë 09.05.2005, lidhur me kundërshtimin të

paraqitur kundër faturës DPR-398 datë 31.3.2005, për borxhin në shumë prej 1.254,13 Euro, në emër të shpenzimit të energjisë elektrike, nga arsyeja se pa të drejtë në banesën e saj nga e paditura është bërë çkqçja nga furnizimi me energji elektrike. Propozon që padia të aprohet e anulohet përgjigja e kontestuar.

Gjykata konstaton se në këtë çështje padia nuk është e lejuar, për këto arsye:

Në nenin 9 par.1 pika 1 të Ligjit për Kontestet Administrative (LKA), parashihet se kontesti administrativ nuk mund të zhvillohet për çështje për të cilat është siguruar mbrojtja gjyqësore jashtë kontestit administrativ.

Në vështrim të nenit 26 par.1 pika 6 e Ligjit të Gjykatave të Rregullta ("Gaz. Zyr. e KSA të Kosovës" nr.21/1978) parashihet që gjykatat komunale do të gjykojnë në kontestet pasurorejuridike.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se kemi të bëjmë me kontest civilo-juridik për vendosjen e të cilit është kompetente të vendosë gjykata komunale në Prishtinë.

Për këto arsye gjykata hudhi padinë si të palejuar, në bazë të nenit 30 par.1 pika 5 dhe nenit 9 të LKA.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, PRISHTINË  
A.nr.392/2005, më 29.07.2005

Procesmbajtësja,  
Ajna Gashi

Kryetar i kolegjit  
Osman Tmava

**[Gjykata Supreme duke vendosur mbi Konfliktin Administrativ- ankesa e refuzuar - kriteret për ndarjen e ndihmës sociale - Rregullorja e UNMIK-ut 2003/28]**

*Paditësi paraqiti ankesë kundër vendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Këshilli i ankesave në Prishtinë, duke bërë pretendimin ankimor se organi i sipërpërmendur administrativ, kishte zbatuar gabimisht të drejtën materiale dhe kishte vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë gjendjen faktike, duke mos marrë parasysh faktin se ai nuk jeton në bashkësi me babain e tij dhe gjendjen e rëndë ekonomike të tij.*

*Qendra për Punë Sociale në Gjilan refuzoi ti ndajë ndihmën sociale paditesit për shkak se ai nuk kishte përmbushur kriteret për ndarjen e ndihmës sociale.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se organi i shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë kishin vërtetuar se familja e paditësit nuk kishte përmbushur kriteret për ndarjen e ndihmës sociale, për shkak se është gjetur se paditësi jeton në bashkësi me babain e tij i cili është përfitues i pensionit në Gjermani. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e paditësit ishte e pabazë.*

A.nr.405/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Osman Tmava, kryetar, Vjosa Nimani-Zylfiu dhe Shahdane Agani, anëtare, me bashkëpunëtoreshen profesionale Ajna Gashi, procesmbajtëse, në kontestin administrativ sipas padisë së paditësit A.N., nga fshati Vërbicë, komuna e Gjilanit, kundër aktvendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Mirëqenies Sociale në Prishtinë nr.02/1247 të datës 09.07.2004, në lëndën e ndihmës sociale, në seancën jopublike të kolegjit të mbajtur më datë 26.07.2005, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet padia.

## A r s y e t i m i

Me aktvendimin e kontestuar është refuzuar ankesa e paditësit kundër aktvendimit të Qendrës për Punë Sociale në Gjilan numër 04-01905, i datës 13.03.2004, me të cilin nuk i pranohet e drejta në ndihmë sociale për arsye se familja e paditësit nuk paraqet rast social.

Paditësi më padi konteston ligjshmërinë e aktvendimit të atakuar për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, duke pohuar se paditësi nuk jeton në bashkësi familjare me babanë, jeton me familjen e tij shtatë anëtarësh, në kushte të rënda ekonomike pa kurrfarë burimi të ardhurave. Propozon që padia të aprovohet e aktvendimi i kontestuar të anulohet.

Organi i paditur nuk ka dhënë përgjigje në padi.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në drejtim të theksimeve të padisë dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatoi se:

Padia është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se organet administrative në procedurën e zhvilluar administrative, me rastin e verifikimit se a i përmbush paditësi kushtet e parashikuara me Rregulloren e UNMIK-ut nr.2003/28 datë 18 gusht 2003, për Skemën e Ndihmës Sociale, kanë konstatuar se jeton në bashkësi familjare me babin i cili gëzon pension të Gjermanisë.

Instituti i paditur, në procedurën sipas ankesës me aktvendimin e kontestuar e ka pranuar në tërësi gjendjen e vërtetuar faktike dhe qëndrimin juridik të organit të faktit-shkallës së parë, për çka ka refuzuar ankesën dhe ka lënë në fuqi aktvendimin e kundërshtuar.

Rregullorja e UNMIK-ut nr.2003/28 datë 18 gusht 2003, për Skemën e Ndihmës Sociale, në nenin 1 përcakton se familja e rrezikuar në aspektin social është ajo familje që përzgjidhet për ndihmë sociale. Në nenin 4 pika 1 kjo rregullore parasheh se, për të fituar të drejtën në ndihmë sociale, të gjithë anëtarët e familjes duhet të jenë banorë të

përhershëm të Kosovës dhe t'i plotësojnë kushtet për kategorizim në njërën prej kategorive vijuese: (a) kategoria e parë e cila në bazë të nenit 2 pika 7 të rregullores nënkupton familjen në të cilën të gjithë anëtarët janë të varur përkatësisht janë të paaftë për punë shpërblyese dhe (b) kategoria e dytë-familja e cila ka një anëtar të aftë për punë dhe të paktën një fëmijë nën moshën 5 vjeçare apo që nën përkujdesje ka një jetim nën moshën 15 vjeçare ose duhet të jenë të varur në kuptim të nenit 2.7 të kësaj rregullore.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme konkludon, se organi i faktit dhe ai i paditur kanë vërtetuar se familja e paditësit nuk i plotëson kushtet ligjore të parashikuara për njohjen e së drejtës së ndihmës sociale, sepse paditësi jeton në bashkësi familjare me babanë i cili është pensionist i Gjermanisë, ka kushte të mira ekonomike, shtëpi të re, traktor, veturë dhe shitore ushqimore në shtëpinë e tij. Këto të dhëna u vërtetuan edhe me datën 18.11.04, nga komisioni për monitorim i organit të faktit, çka rezultoi nga formulari për verifikimin e gjendjes sociale të paditësit.

Lidhur me këtë, gjykata konstaton se në këtë çështje administrative drejtë është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cënuar ligji në dëm të paditësit, prandaj theksimet e padisë nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendjeje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga ana e organeve administrative, kështu që, në vështrim të nenit 42 par.2 të LKA, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, PRISHTINË  
A.nr.405/2005, më 26.07.2005

Procesmbajtësja,  
Ajna Gashi

Kryetari i kolegjit,  
Osman Tmava

**[Gjykata Supreme duke vendosur mbi Konfliktin Administrativ ankesa e refuzuar TVSH - neni 40 (1) LKA - Rregullorja e UNMIK-ut nr.2000/20 mbi administratën dhe procedurën tatimore - neni 2, (2), (12) LKA]**

*Paditësi, Administrata Tatimore e Kosovës paraqiti ankesë kundër vendimit të Bordit të Pavarur për Rishqyrtime në Prishtinë, duke bërë pretendim ankimor se organi i sipërpërmendur administrativ, kishte zbatuar gabimisht të drejtën materiale dhe kishte vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë gjendjen faktike.*

*Bordi i Pavarur për Rishqyrtime në Prishtinë ia ka zbritur tatimin e paragjykuar tatimpaguesit.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se me vendimin e kontestuar, paditësit nuk i është cënuar asnjë e drejtë apo interes i drejtpërdrejtë i bazuar në ligj, ngase ajo nuk mund të jetë bartëse (titullar) e së drejtës apo detyrimit për të cilin është vendosur në procedurën e zhvilluar administrative të parashikuar nga neni 2 paragrafi 2 dhe Neni 12 i LKA dhe Rregullorja e UNMIK-ut nr.2000/20 mbi administratën dhe procedurën tatimore. Prandaj Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e paditësit është e pabazuar.*

A.nr.414/2003

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Vjosa Nimani-Zylfiu, kryetare, Osman Tmava dhe Meleqe Behxheti, anëtarë, me bashkëpunëtoreshen profesionale Ajna Gashi, procesmbajtëse, në kontestin administrativ sipas padisë së paditëses Administrata Tatimore e Kosovës, kundër anës së paditur Bordit të Pavarur për Rishqyrtime - Prishtinë, për prishjen e vendimit të anës së paditur nr.96/2003 datë 23.9.2003, në seancën e mbajtur më 21.7.2005, mori këtë

**A K T V E N D I M**

Hidhet poshtë padia e paditëses Administrata Tatimore e Kosovës e paraqitur kundër vendimit të Bordit të pavarur për rishqyrtime nr.96/2003 datë 23.9.2003.

**A r s y e t i m i**

Ana e paditur me vendimin nr.96/2003 datë 23.9.2003, pjesërisht e ka pranuar si të bazuar ankesën e tatimpaguesit NTSH “NIC-Holding” me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër vendimit të Departamentit të ankesave Administratës tatimore të Kosovës, ashtu që tatimpaguesit ia ka zbritur tatimin e paragjykuar për shumën prej 2.834,19 € dhe tatimin në vlerën e shtuar për 30.550,95€, për të cilat vlera tatimpaguesi është liruar nga detyrimi i pagimit të tatimit; me pjesën e dytë e ka refuzuar ankesën dhe aktvendimin e goditur e ka lënë në fuqi.

Paditësja në padinë e paraqitur kundërshton ligjshmërinë e paragrafit të parë të vendimit të lartpërmendur, duke theksuar se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, se ligji është zbatuar në mënyrë të gabuar, ndërsa vendimi i kontestuar është edhe kontradiktor për arsye se dispozitivi i tij është në kundërshtim me provat në lëndë dhe arsyet e dhëna. Ka propozuar që padia të miratohet dhe vendimi i kontestuar të anulohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi që, në përputhje me dispozitën e parashikuar me nenin 40 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), e shqyrtoi vendimin e kontestuar, dhe pasi që i vlerësoi thëniet në padi dhe shkresat e lëndës, ka gjetur se:

Padia nuk është e lejueshme.

Nga shkresat e lëndës del se me paragrafin e parë të vendimit nr.96/2003, ana e paditur e ka pranuar pjesërisht ankesën e tatimpaguesit NTSH “NIC Holding” me seli në Prishtinë dhe ka bërë korrigjimin-nënvlerësimin e tatimit ashtu që tatimpaguesin e ka liruar nga detyrimi për pjesën e tatimit shtesë për tatimin e paragjykuar për vlerën 2.834,19 € si dhe tatimi në vlerën e shtuar për 30.550,95 €; me pjesën e dytë e ka refuzuar ankesën dhe aktvendimin e goditur e ka lënë në fuqi.

Gjykata Supreme vlerëson se padia është e palejueshme.

Me dispozitën e nenit 12 të LKA parashikohet se paditës në procedurën e konfliktit administrativ mund të jetë individ, personi

juridik, organizata, grupi i qytetarëve e ngjashëm, i cili konsideron se me aktin administrativ i është cënuar ndonjë e drejtë ose interes i drejtpërdrejt i bazuar në ligj.

Me dispozitën e parashikuar nga neni 2 par.2 parashikohet se organet shtetërore edhe pse nuk e kanë cilësinë e personit juridik mund të iniciojnë kontest administrativ nëse mund të jenë bartës të drejtave dhe detyrimeve për të cilat është vendosur në procedurën administrative apo, nëse atyre u është cënuar ndonjë interes i drejtpërdrejtë i bazuar me ligj.

Paditësja në përputhje me dispozitat e sipër cekura të LPPA dhe në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr.2000/20, mbi Administratën dhe Procedurën Tatimore, me rastin e vendosjes sipas kërkesës së palës për rishqyrtim të vlerësimit zyrtar, ka zbatuar procedurë dhe ka vlerësuar zbatimin e dispozitave ligjore të cilat kanë të bëjnë me caktim të një detyrimi për tatimpaguesin. Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se me vendimin e kontestuar paditëses nuk i është cënuar asnjë e drejtë apo interes i drejtpërdrejtë i bazuar në ligj ngase ajo nuk mund të jetë bartëse e së drejtës apo detyrimit për të cilin është vendosur në procedurën e zhvilluar administrative.

Nga sa u tha më lart e me zbatimin e nenit 30 par.1 pika 3 të LKA, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, PRISHTINË  
A.nr.414/2003, më 21.07.2005

Procesmbajtësja,  
Ajna Gashi

Kryetarja e kolegjit,  
Vjosa Nimani-Zylfiu

**[Gjykata Supreme duke vendosur mbi Konfliktin Administrativ ankesa e refuzuar e drejta për pension invalidor - neni 40 (1) LKA - neni 3 Ligji Nr. 2003/23 mbi Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë]**

*Paditësi paraqiti ankesë kundër vendimit të Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës, duke bërë pretendimin ankimor se organi i sipërpërmendur administrativ kishte zbatuar gabimisht të drejtën materiale dhe kishte vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë gjendjen faktike, duke mos marrë parasysh faktet se gjendja e tij shëndetësore është e rëndë dhe paafhtësinë e tij për punë.*

*Departamenti i Administratës Pensionale refuzoi të ndajë pensionin invalidor paditësit për shkak se komisioni mjekësor kishte vlerësuar se te paditësi nuk ekziston aftësia e kufizuar e përhershme.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se si organi i shkallës sëparë ashtu edhe ai i shkallës së dytë kishte zbatuar gjatë vërtetimit të gjendjes faktike, në mënyrë të drejtë dhe të plotë kanë zbatuar dispozitat e procedurës së përgjithshme administrative dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se paditësi nuk i ka përmbushur kriteret e parashikuara me nenin 3 të Ligjit nr. 2003/23 mbi Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e paditësit është e pabazuar.*

A.nr.595/2005

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Osman Tmava, kryetar, Shahdane Agani dhe Vjosa Nimani-Zylfiu, anëtare, me bashkëpunëtoren profesionale Ajna Gashi, procesmbajtëse, në kontestin administrativ sipas padisë së paditësit Xh.B., nga fshati Lubeniq, komuna e Pejës, kundër aktvendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale Këshilli i ankesave për pensionet e personave me aftësi të kufizuar, nr.5011887 datë 07.04.2005, në lëndën e pensionit, në seancën jopublike të mbajtur më datën 26.07.2005, mori këtë

## A K T G J Y K I M

Refuzohet padia.

## A r s y e t i m i

Me aktvendimin e kontestuar është refuzuar si e pabazë ankesa e paditësit e paraqitur kundër vendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës, në Prishtinë, nr.5011887 datë 04.11.2004, me të cilën është refuzuar kërkesa që paditësit t'i njihet e drejta për pension me aftësi të kufizuar.

Paditësi me padi konteston ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar, duke pohuar se komisionet mjekësore të paditurës, nuk morën parasysh faktet se gjendja e tij shëndetësore është e rëndë, se nuk është i aftë për punë dhe provat e prezantuara, organet administrative nuk i morën parasysh, për çka edhe gjendja e fakteve nuk u vërtetua në mënyrë të plotë. Kështu, edhe erdhi deri te zbatimimi i të drejtës materiale në dëm të tij. Propozon që padia të aprovohet, e aktvendimi i kontestuar të anulohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të vendimit të kontestuar sipas nenit 40 par.1 të Ligjit të Kontesteve Administrative (LKA), vlerësimi të thënieve në padi dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se:

Padia është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës shihet se organi i shkallës së parë me vendimin nr.5011887 datë 04.11.2004, paditësit ia refuzon kërkesën për njohjen e të drejtës në pension me aftësi të kufizuar nga arsyeja se nuk i plotëson kriteret sipas nenit 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr.2003/40 datë 17.12.2003 të Ligjit për Pensionet e personave me aftësi të kufizuar, dhe të njëjtin e bazon në konstatimin dhe mendimin e komisionit mjekësor të organit të shkallës së parë, datë 30.10.2004, i cili vlerëson se te paditësi nuk është paraqitur kufizimi i përhershëm i aftësisë punuese si parasheh dispozita e sipër cekur ligjore.

Në procedurën e ankesës organi i paditur siguron konstatimin dhe mendimin e komisionit mjekësor të paditurës nr.5011887 datë 07.04.2005, për vlerësimin e komisionit mjekësor të personave me aftësi të kufizuara të organit të faktit, i cili dakordohet me konstatimin dhe mendimin e komisioneve mjekësore, prandaj edhe me vendimin e

kontestuar refuzon si të pabazuar ankesën e paditësit dhe vërteton vendimin e atakuar.

Duke pasur parasysh se komisionet mjekësore me ligj të autorizuar, kanë vërtetuar se te paditësi nuk ekziston aftësia e kufizuar për punë, gjykata konstaton se organet administrative drejt kanë zbatuar dispozitën e nenit 3 të Ligjit të cekur më lart, në bazë të cilit edhe është refuzuar kërkesa e paditësit që t'i njihet e drejta në pension invalidor.

Gjykata vlerësoi theksimet e padisë dhe konstatoi se të njëjtat në këtë çështje administrative nuk kanë ndikim në vendosjen tjetër, sepse me provat e administruara në vështrim të dispozitës së cekur ligjore pa mëdyshje është vërtetuar që paditësi nuk i plotëson kushtet ligjore për njohjen e së drejtës së kërkuar, prandaj në vështrim të nenit 42 par. 2 të LKA vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, PRISHTINË  
A.nr.595/2005, më 26.07.2005

Procesmbajtësja,  
Ajna Gashi

Kryetari i kolegjit,  
Osman Tmava